



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PREDSIEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	12.01.2026.
01 NR/BR.	05/26

PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës.
PËRMES/PREKO/RTHROUGH	Komitetit për Politikë dhe Financa Kryesuesit të Kuvendit të Komunës Xhavit Zariqi
NGA/OD/FROM	Kryetar i Komunës z. Agim Aliu
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim Vendim për miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit në mes të Komunës së Ferizajt dhe Caritas Kosova.

Në bazë të nenit 58 pika 1. h. të Ligjit, Nr. 03/L -040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 pika 2.9, të Statutit Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50, i datës 28.06.2013, Kryetari i Komunës bënë këtë:

PROPOZIM VENDIM

Propozim-Vendim për miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit në mes të Komunës së Ferizajt dhe Caritas Kosova.

A r s y e t i m

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Bashkëfinancimi është e rëndësishme për Komunën e Ferizajt sepse synon drejtpërdrejt rritjen e punësueshmërisë së të rinjve dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës. Projekti ka vlerë të përgjithshme prej **138.175 euro**, ku **projekti "Your Job" i Caritas Kosova financon 66% të vlerës**, ndërsa **Komuna e Ferizajt kontribuon me 43%**, duke siguruar një partneritet të qëndrueshëm financiar. Përmes këshillimit në karrierë, trajnimeve profesionale, praktikës në punë dhe zhvillimit të ndërmarrësisë, adresohen nevojat konkrete të të rinjve, veçanërisht të atyre nga grupet e marginalizuara. Ky bashkëpunim sjell ekspertizë profesionale, rrit efikasitetin e shpenzimit të mjeteve publike dhe krijon ndikim të drejtpërdrejtë socio-ekonomik në Komunë.

Andaj propozoj që kjo Marrëveshje si e tillë të miratohet.



Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale me Nr. 03/L-040, Ligjit Nr. 04/L045 për Partneritet Publiko-Privat, neni 2 pika 1.7, neni 3 pika 1.12.1 dhe neni 11, Ligji nr. 06/L092 neni 5 pika 1.3, neni 8 pika 1.3.

Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Bashkëfinancimi

në mes të

Komunës së Ferizajt

dhe

Caritas Kosova

Neni 1

Qëllimi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi lidhet në mes të Komunës së Ferizajt, prezantuar nga, z. **Agim Aliu - Kryetar i Komunës**, dhe Caritas Kosova, me nr. të regjistrimit: 5200022-0, Ferizaj, prezantuar nga **Don Viktor Sopi, Drejtor Gjeneral**, me qëllim të bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit të projektit të përbashkët me titull:

Ofrimi i shërbimeve të përgatitjes dhe këshillimit të të rinjve të Komunës së Ferizajt për tregun e punës.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo marrëveshje parasheh zbatimin e programit të Punësimit dhe aktivitetet kryesore fokusohen në:

- **Këshillimin në karrierë,**
- **Trajnime në soft-skills**
- **Trajnime profesionale**
- **Praktikë në punë**

Neni 3

Kohëzgjatja

Periudha kohore e zbatimit të Marrëveshjes është dy-vjeçare, duke filluar nga 01.01.2026 deri më 30.06.2027.

Neni 4

Obligimet e Palëve

Caritas Kosova, programi i punësimit synon rritjen e aftësive profesionale dhe profilizimit të rinjve dhe mundësive të punësimit për të rinjtë në rajon. Programi nxit rritjen e punësueshmërinë së rinjve që janë pjesë e grupeve të marxhinalizuara, ofron perspektiva të reja dhe mundësi punësimi për të rinjtë në Kosovë, respektivisht në komunën e Ferizajt. Ky program 2 vjeçar ka vlerë prej **138, 175.00 Euro**.

Komuna e Ferizajt dhe Caritas Kosova janë institucionet bashkëpunuese dhe bashkëfinancuese të projekti dhe do të menaxhojnë dhe përcjellin nga afër tërë zbatimin e Marrëveshjes.

Ky qëllim do të arrihet përmes katër rezultateve të ndërlidhura, konkrete dhe zhvillimit të aktiviteteve vijuese: **1) orientimin profesional dhe informacionin mbi mundësitë e vetëpunësimit dhe trajnimit, orientimin cilësor në karrierë, mbështetje 2) trajnime aftësishë, 3) praktikë pune dhe 4) trajnime në ndërmarrësi për të rinjtë.**

Fushat e bashkëpunimit të cilat parashikohet të zbatohen nga ky bashkëpunim janë:

Praktika në Punë: Ky bashkëpunim do të mundësoj praktika për të rinjtë e Ferizajt në vend-pune në periudhë prej minimum 3 muaj. Përzgjedhja e praktikantëve është përmes qasjes individuale dhe zhvillimit të tyre në karrierë si dhe ndërmjetësimi i tyre me punëdhënësit potencial.

Trajnime profesionale: për ndërmarrësi dhe të bërit biznes - Ky bashkëpunim u mundëson aplikuesve të rinj të përgatiten dhe të rrisin njohuritë e tyre personale dhe profesionale në ndërmarrësi. Pas përfundimit të trajnimit, përfituesit do të garojnë me idetë e tyre për grant.

*Me qëllim të zbatimit të Marrëveshjes **Caritas Kosova** merr përgjegjësi këto obligime:*

4.1 Caritas Kosova do të ofroj stafin e vet (Këshilltarin Social) të cilët do të punojnë drejtpërdrejtë me të rinjtë e komunës, në evidentimin e nevojave të rinjve për përgatitjen për tregun e punës.

- 4.2 Caritas Kosova do të mbështes të rinjtë e Komunës nga mosha 15 deri në moshën 35 vjeçare, përmes ofrimit të shërbimeve konsultative dhe përgatitjen profesionale të tyre për nevojat e tregut të punës përmes ofrimit të trajnimeve profesionale dhe akademike.
- 4.3 Caritas Kosova do të angazhohet në bashkëpunim të ngushtë me bizneset e komunës së Ferizajt për tu siguruar për nevojat e bizneseve për kualifikimet e nevojshme profesionale që kërkohen në tregun e punës. Bazuar në këtë analizë, Caritas Kosova do të ju ofroj të rinjve mundësi për punë praktike në bizneset Komunës së Ferizajt.
- 4.4 Caritas Kosova do të ofroj trajnime ndërmarësie për idetë inovative të të rinjve për vetë-punësim, punësim, ndërmarrësi sociale, etj.
- 4.5 Të gjitha raportet e realizuara dhe hulumtimet e bëra nga Caritas Kosova, do ti jepen në shfrytëzim Komunës, për të ndërtuar politika dhe plane zhvillimore që mbështesin përgatitjen profesionale të të rinjve për punësim.
- 4.6 Caritas Kosova është pala përgjegjëse për zbatimin e projektit ku do të menaxhoj dhe përcjellë nga afër tërë veprimtarinë e stafit dhe zbatimin e aktiviteteve sipas projekt propozimit.
- 4.7 Caritas Kosova do të bashkëpunojë me institucionet relevante të Komunës së Ferizajt, me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoritë relevante, dhe do të përgatis raporte sipas Nenit 5 për të prezantuar zhvillimin e projektit, rezultatet e arritura si dhe raportet financiare.

*Me qëllim të zbatimit të marrëveshjes **Komuna e Ferizajt** merr përgjegjësi këto obligime:*

- 4.8 Komuna do të ofroj mbështetje profesionale, përmes resurseve njerëzore (zyrtarëve komunal) në mbështetje të realizimit të qëllimit të përcaktuar në pikën 1 të kësaj marrëveshje.
- 4.9 Komuna do të ofroj mbështetje logjistike-infrastrukture, për organizimin e aktiviteteve të parapara në projekte të ndryshme, të cilat mundësojnë përgatitjen profesionale për të rinj.
- 4.10 Komuna do të angazhohet në rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimin edhe më institucione dhe organizata të tjera relevante, përvoja e të cilave mund ti shërbej Caritas-it, në implementimin e suksesshëm të projektit që mbështesin të rinjtë.
- 4.11 Komuna, përmes drejtorive përkatëse, si: Drejtoria e Arsimit, Drejtoria për Rini Kulturë dhe Sport, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit dhe drejtorive të tjera, do të mundësoj qasjen në shkollat dhe institucionet tjera, ku të rinjtë do informohen për shërbimet që ofron Caritas Kosova në përgatitjen e të rinjve për tregun e punës.
- 4.12 Komuna do të promovoj projektet dhe mundësitë e ofruara nga Caritas Kosova për të rinjt në hapësirat zyrtare të komunikimit dhe informimit, si ëeb, facebook page, etj.
- 4.13 Të monitoroj zbatimin e projektit.
- 4.14 Të kryej obligimet financiare të përcaktuara në Marrëveshje.

Raportimi dhe Menaxhimi

Të dy Palët emërojnë Personin Përgjegjës për zbatimin e Marrëveshjes. Komuna e Ferizajt emëron z. Muharrem Fazliun Person Përgjegjës për menaxhimin e kësaj Marrëveshje.

Caritas Kosova emëron znj. Shqipe Kurti Person Përgjegjës për menaxhimin e kësaj Marrëveshje.

Caritas Kosova do të hartoj raporte gjashtë mujore dhe vjetore në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes, realizimit të shpenzimeve si dhe rezultateve të arritura.

Personi Përgjegjës nga Komuna e Ferizajt do të mbikëqyr të gjitha aktivitetet dhe do të aprovoj raportet narrative dhe raportet financiare, të cilat prezantohen nga Personi Përgjegjës i Caritas Kosova.

Hartimi i raporteve financiare do të bëhet në format të aprovuar nga të dy Palët dhe do të jetë konform Aneks 1 – Planifikimi Financiar YourJob+, pjesë e kësaj Marrëveshje.

Shpenzimet në lidhje me Marrëveshjen do të realizohen në pajtueshmëri me Rregulloren Financiare të Caritas Kosova.

Neni 6

Financimi

Komuna e Ferizajt dhe Caritas Kosova do të bashkëfinancojnë realizimin e kësaj Marrëveshje me kosto të përgjithshme në vlerë prej **138, 175.00 Euro**, sipas **Aneks 1 - Planifikimi Financiar YourJob+**.

Komuna e Ferizajt do të bashkëfinancoj shumën prej **43%**, në vlerë totale prej **60,020.00 Euro** nga Kodi 48072- kategoria: mallra dhe shërbime. **Kjo shumë do shpenzohet vetëm për qytetarët e Komunës së Ferizajt.**

Caritas Kosova, do të bashkëfinancoj shumën prej **66%** apo **78,155.00€**, nga vlera totale prej **138,175.00 Euro**.

Gjithsejt vlera e bashkëfinancimit nga Komuna e Ferizajt do të transferohet në llogarinë bankare të Caritas Kosova (Caritas Kosova 1170-017001-0001-63, ProCredit Bank).

Palët në Marrëveshje pajtohen që në rast të sigurimit të donacioneve tjera, ato të inkorporohen në Planifikimin Financiar të kësaj Marrëveshje me qëllim të realizimit dhe zgjerimit të projektit.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjes

Palët nënshkruese të Marrëveshjes pajtohen që me mirëkuptim, konsultim dhe negociim të zgjidhin të gjitha çështjet kontestuese që mund të lindin gjatë zbatimit të Marrëveshjes. Në të kundërtën kompetente është Gjykata Themelore në Ferizaj.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe është e përpiluar në 4 ekzemplar të njëjtë, nga dy për secilën palë.

Data e nënshkrimit: _____

Palët nënshkruese

Agim Aliu

Kryetar

Komuna Ferizaj

Don Viktor Sopi

Drejtor Gjeneral

Caritas Kosova
